




Deklaratat e analizuara:

11 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2006 deri Periodik/Vjetor 2016)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016




Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2016 është rritur 3.8 herë

+ 1,506,301 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete në Bankë



Pasuritë e Luajtshme



Pasuritë e Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2006-2016	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	8,864,130	50.9%
Të ardhura nga aktiviteti i bashkëjetuesit	6,270,425	36.0%
Të ardhura nga interesat e Bono Thesari	2,270,102	13.0%
Total	17,404,657	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 10 vite rezultoi:

1 Me probleme
9 Pa probleme

Gjyqtarja Migena Laska deklaron gjatë viteve shtim të likuiditeteve cash me burim nga interesat e bonove të thesarit si dhe nga kursimet nga paga, një pjesë e së cilave janë pakësuar ndër vite si burime për blerje asetesh. Në vitin 2016, subjekti deklaron se në zbatim rigoroz të ligjit të vetingut, i ka depozituar të gjitha kursimet cash në shumën 25,533 euro në llogarinë bankare në Raiffeisen Bank. Megjithatë, gjendja e akumuluar cash deri me datë 31.12.2016 rezulton më e ulët sesa vlera 25,533 euro, duke e nxjerrë subjektin me pamjaftueshmëri burimesh në vitin 2016 në shumën 601,218 lekë.

Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit deklaron dhuratë në cash nga bashkëjetuesi në vlerën e 24,000 eurove, me burim nga shitja e një apartamenti në vitin 2014 si dhe kursime të tjera që i dispononte vetë dhuruesi në llogarinë e tij bankare. Në vitin 2015 deklarohet pagesa e këstit të dytë prej 10,000 eurosh për një kontratë porosie të lidhur në vitin 2014 me subjektin Lura sh.p.k për ndërtimin e një apartamenti. Kontrata e porosisë si dhe pagesa e këstit të parë nuk rezultojnë të jenë deklaruar më parë.